



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

**Gusht, 2019**

**Kanë rinisur trajnimet e organizuara nga SBASHK**


Takim konsultativ me kryetarët e SAF e SAM te komunave dhe te Universiteteve

### Analizë e gjendjes në institucionet arsimore



Nismë e mbarë e trajnimit për mediet dhe rolin ...(faqe 7)

**Intervistë me mësimdhënësen Merita Bislimi Zhinipotoku**



Të jemi sa më aktiv në angazhimet e SBASHK-ut

Merita është (faqe 3)

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me stafin udhëheqës kanë mbajtur një takim konsultativ me kryetarët e Kuvendeve të Sindikatave të Arsimit Fillor e të Mesëm të Kosovës. Temë kyçe e bashkëbisedës në këtë takim ka qenë analiza e gjendjes aktuale në arsim . Nga prezantimet e kryetarëve të Kuvendeve të Sindikatave të Arsimit Fillor e të Mesëm të Kosovës është parë se ...(faqe 4)

Takim me drejtorin e Departamentit të Pensioneve të Kosovës



**U bashkëbisedua për fillimin e aplikimit për Ligjin e viteve të 90-ta**

Më 15 gusht ka nisur aplikim punëtorëve të arsimit shqip për të gëzuar...(faqe 6)

Kryetari i Kamenicës Qëndron Kastrati vizitoi selinë e SBASHK-ut



**SBASHK- Me të gjitha mundësitë do të kundërshtohet mbyllja e shkollave**

Kryetari i Kamenicës Qëndron Kastrati me bashkëpunëtorët , i shoqëruar ....(faqe 4)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

## Editorial

### Viti i ri shkollor



Vera iku shpejt dhe shtatori shënon fillimin edhe të një viti të ri shkollor dhe të rinisjes së betejës për dije të reja. Viti i kaluar shkollor ishte konsideruar me të drejtë nga më të vështirët dhe po shpresonim se janë kaluar shumë sfida e janë shënuar edhe arritje të konsiderueshme dhe se për një kohë do të frymojmë më lirshëm.

Por, kjo nuk po ndodh. Një ide e pa analizuar mirë e kryetarit të Kamenicës, që gjoja në emër të reformave të mbyll ca shkolla atje, e prishi heshtjen dhe hodhi poashtu mendimin për një fillim të qetë të vitit shkollor.

SBASHK-u zhvilloi takime me kryetarët e shoqatave sindikale në Kamenicë dhe duke respektuar zërin e tyre ia bëri me dije me kohë Kastratit që nëse vazhdon në kërkim të implementimit të asaj ide të pa

menduar e analizuar mirë në Kamenicë do të ketë veprime sindikale të cilat mund të qojnë në grevë të përgjithshme në gjithë institucionet arsimore në këtë komunë e me mundësi që në emër të solidaritetit të dëshmuar sindikal veprime sindikale do të ketë edhe në tërë sistemin arsimor të Kosovës.

SBASHK-u edhe në takimin me kryetarin Kastrati dhe stafin tij e me një OJQ, që ishte ideatore e idesë për mbyllje shkollash, përsëriti apelin që kjo ide të mos zbatohet dhe ia bëri me dije Kastratit se në të kundërtën do të përballet me veprime sindikale.

SBASHK-u pret që të mbizotërojë arsyeja dhe që të hiqet dorë nga kjo ide në mënyrë që për gjithë çështjet të veprohet me dialog e marrëveshje e jo me veprime të ngutshme e të njëanshme.

Duhet ta dinë të gjithë se SBASHK-u janë të gjithë punësuarit në arsimin e Kosovës dhe pa të nuk mund të veprohet e vendoset për arsimin tonë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)**

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)


Tel. +381(0)38/ 226 940





## Intervista

### *Intervistë me mësimdhënësen Merita Bislimi Zhinipotoku* **Të jemi sa më aktiv në angazhimet e SBASHK-ut**



Merita është mësimdhënëse e gjuhës angleze. Ajo është e përkushtuar në profesion, por edhe në aktivitetet e organizuara nga SBASHK në shërbim të anëtarësisë.

Ajo me të drejtë thotë se profesioni i mësimdhënësit është i vështirë, por edhe human sepse arsimon brezat.

Arsimimi sot:

**Kush është Merita Bislimi Zhinipotoku?**

Merita:

Jam Merita Bislimi Zhinipotoku, punoj në SHFM “Halit Ibishi” në fshatin Cërnillë si mësimdhënëse e gjuhës angleze që nga viti 1996. Anëtare e SBASHK-ut jam që nga themelimi i kësaj organizate.

Arsimimi sot:

**Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënësit sot?**

Merita:

Sipas mendimit tim profesioni i mësimdhënësit sot është një profesion mjaft i vështirë sepse vazhdimisht përballesh me sfida të ndryshme duke filluar nga kurrikula, mungesa e teksteve shkollore të hartuara sipas kurrikulës, hartimi i programeve mësimore, sigurimi i fondit të orëve. Përveç kësaj edhe puna me fëmijët dhe komunikimi me rrethin është një sfidë e veçantë që kërkon përkushtim.

Arsimimi sot:

**Si ndiheni si kryetare e shoqatës sindikale në shkollën “Halit Ibishi”?**

Merita:

Për mua të jesh kryetare e shoqatës sindikale nuk është një privilegj, por një përgjegjësi dhe meqë zgjedhja ime në këtë funksion ishte propozim njëzëri nga kolektivi, atëherë unë gjatë kryerjes së këtij funksioni do të jem përgjegjëse dhe llogaridhënëse.

Arsimimi sot:

**Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut?**

Merita:

Mendoj se SBASHK-u ka pasur shumë të arritura e unë në këtë intervistë do të veçoja disa nga ato që mendojë se kanë vlerë të veçantë të arritjeve siç janë miratimi i Ligjit për punëtorët e arsimit gjatë viteve 90-99, pastaj Ligji mbi pagat, realizimi i tri pagave përcjellëse në shumë komuna për kolegët tanë të pensionuar, organizimi i shumë trajnimeve me qëllim që t’u ndihmohet kolegëve tanë kudo në Kosovë që të arrijnë njohuri të reja në lëmi të caktuara, por edhe që të arrijnë numrin e duhur të orëve të trajnimit që kërkohen për licencë dhe gradime.

Arsimimi sot:

**Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta?**

Merita:

Sugjerimi im është që SBASHK të fokusohet më shumë në organizimin e trajnimeve për mësimdhënësi pasi që çdo mësimdhënësi për licencim i nevojiten 100 orë trajnim gjatë 5 viteve, pastaj kërkesat të cilat SBASHK veç i ka ngritur vazhdimisht si ora e kujdestarisë, pagesa e udhëtimit të mësimdhënësve e kërkesa të tjera.

Arsimimi sot:

**Çka ju sugjeroni mësimdhënësve që nuk janë aktiv sa duhet në SBASHK?**

Merita:

Inkurajoj mësimdhënësit që të jenë sa më aktiv në SBASHK sepse përfitimet pastaj janë njësoj për të gjithë dhe se çdo të drejtë punëtorët mund ta arrijnë vetëm përmes organizatave sindikale dhe jo individualisht.

Takim konsultativ me kryetarët e SAF e SAM te komunave dhe te Universiteteve

### Analizë e gjendjes në institucionet arsimore

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me stafin udhëheqës kanë mbajtur një takim konsultativ me kryetarët e Kuvendeve të Sindikatave të Arsimit Fillor e të Mesëm të Kosovës.



Temë kyçe e bashkëbisedës në këtë takim ka qenë analiza e gjendjes aktuale në arsim. Nga prezantimet e kryetarëve të Kuvendeve të Sindikatave të Arsimit Fillor e të Mesëm të Kosovës është parë se nuk ka probleme të theksuara dhe se viti shkollor do të nis i mbarë, por kjo u tha, nuk vlen edhe për komunën e Kamenicës sepse kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, gjoja në emër të reformës, ka planifikuar të mbyll një numër shkollash, ide të cilën kolegët tanë në Kamenicë e kanë kundërshtuar bashkë me kryesinë e SBASHK-ut.

Edhe nga ky takim SBASHK-u i është drejtuar kryetarit Kastrati që të heq dorë nga ideja e tij dhe çështja e rënies së vazhdueshme të numrit të nxënësve të ngritet në nivel qendror dhe të bëhet një strategji e qëndrueshme për tërë Kosovën duke iu dhënë

përgjigje meritore të gjitha shqetësimeve të arsyeshme të personelit arsimor.

Nga ky takim doli vendimi që nëse kolegët tanë në Kamenicë do të nisin me veprime sindikale në angazhimin për të mos lejuar mbylljen e shkollave atje, atëherë të gjithë anëtarët e SBASHK-ut nga e tërë Kosova do të solidarizohen me ta me veprimet sindikale që do t'i vendos Këshilli Drejtues i SBASHK-ut.

Në këtë takim i është bërë apel kryetarëve të Kuvendeve të Sindikatave të Arsimit Fillor e të Mesëm të Kosovës që të jenë në komunikim të vazhdueshëm me kryetarët e sindikatave sindikale në mënyrë që të veprohet me kohë nëse paraqiten probleme eventuale. Po ashtu ata janë informuar se do të vazhdohet me ritëm të shpejtuar me 5 trajnimet e licencuara në mënyrë që t'u ndihmohet sa më shumë kolegëve tanë që të kenë sa më shumë orë të trajnimeve të licencuara.



Kryetari i Kamenicës Qëndron Kastrati vizitoi selinë e SBASHK-ut

### SBASHK- Me të gjitha mundësitë do të kundërshtohet mbyllja e shkollave

Kryetari i Kamenicës Qëndron Kastrati me bashkëpunëtorët, i shoqëruar edhe nga anëtarët e një OJQ-je, që është ideatore e idesë së mbylljes së një numri shkollash, duke u përballur me reagimin publik

të SBASHK-ut kundër kësaj ideje, ka vizituar selinë e SBASHK-ut dhe kanë zhvilluar një bashkëbisedë të gjatë me stafin e sindikatës së arsimit.



Gjithë ajo që është përsëritur nga z. Kastrati dhe anëtarët e kësaj OJQ-je se ideja është në dobi të nxënësve dhe punëtorëve të arsimit nuk ka qenë e mbështetur në argumente të qëndrueshme dhe është kundërshtuar me argumente nga kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe stafi tjetër i kësaj sindikate.



Ata kanë përsëritur se duke përfaqësuar zërin e punëtorëve të arsimit të Kamenicës dhe komunave tjera dhe duke iu bashkëngjitur kundërshtimit të pjesës më të madhe të prindërve nga kjo komunë janë kundër mbylljes së shkollave atje dhe kanë kërkuar nga kryetari Kastrati që ta tërheq këtë ide në mënyrë që viti shkollor edhe në Kamenicë të filloi pa probleme. Në të kundërtën i është bërë me dije se do të përballlet me reagimet sindikale, gjegjësisht me grevën në të gjitha shkollat e kësaj komune dhe me solidaritetin e punëtorëve të arsimit nga e tërë Kosova.



SBASHK-u i ka bërë me dije kryetarit Kastrati se shteti i Kosovës ka paraparë në buxhetin e vitit 2019 mjete për numrin aktual të punëtorëve të arsimit dhe

se edhe në të ardhmen do të punohet që të ketë buxhet të mjaftueshëm sepse pak kush në Kosovë do të përkrah mbylljen e shkollave, por ka shumë më tepër të angazhuar që të përmirësohen kushtet e punës në shkolla dhe nëse gjendja në disa shkolla të Kamenicës sa i takon objekteve përcjellëse është e keqe, atëherë kjo nuk përmirësohet me mbyllje shkollash, por përgjegjësinë për gjendjen e bartin institucionet gjegjëse lokale.



Kryetari i SBASHK-ut Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë ngritur shumë pyetje që duhen dhënë përgjigje lidhur me këtë iniciativë dhe janë shprehur se nuk janë të autorizuar OJQ-të që të merren me veprime në arsimin e Kosovës, por se me këto duhet të merren institucionet qendrore dhe ato lokale duke analizuar çdo imtësi në mënyrë që të mos kemi dështime të veprimeve e dëme që i janë shkaktuar arsimit me eksperimente të vazhdueshme në bazë të tekave të individëve.

Në këtë takim kryetari Kastrati pohoi se ideja e tij nuk është debatuar në asnjë seancë me asamblistët e kësaj komune, duke konsideruar se për këtë nuk ka nevojë.

Udhëheqësit e SBASHK-ut të nivelit qendror edhe në këtë takim, në të cilin mori pjesë edhe kryetari i sindikatës së arsimit fillor e të mesëm të Kamenicës, Nazim Jakupi, i bënë edhe një apel kryetarit Kastrati që të heq dorë nga kjo ide e ngutshme dhe e pa analizuar mirë dhe për çështje të tilla të debatohet në nivelin qendror pas konstituimit të institucioneve të Kosovës që do të dalin nga zgjedhjet e lira të tetorit ose do të përballlet me reagimin konkret dhe me veprimet sindikale.

## Në përpjekje që problemet në arsimin e Kamenicës të zgjidhen me dialog **SBASHK i drejtohet MASHT-it për angazhim konkret**

Duke u angazhuar në vazhdimësi që çështjet e ngritura të zgjidhen drejt dhe me dialog SBASHK-u pas takimeve me anëtarësinë në Kamenicë dhe me kryetarin e kësaj komune Qëndron Kastrati, idenë e mbylljes së shkollave e ka kundërshtuar edhe në takimin e Këshillit Shtetëror të Licencimit përmes kryetarit Rrahman Jasharaj.

Në vazhdën e këtij angazhimi SBASHK-u i ka dërguar edhe një letër zyrtare Drejtorit të Departamentit të Arsimit Parauniversitar, z. Alush Istogu duke kërkuar angazhimin e tij me qëllim që Kastrati të tërhiqet nga ideja e tij e pa analizuar mirë për mbyllje shkollash. Në këtë letër, veç tjerash thuhet:

“I nderuari Drejtor Istogu, duke shprehur respektin tonë për angazhimin dhe përkushtimin tuaj të vazhdueshëm në shërbim të arsimit të Kosovës, Ju drejtohem me lutjen që të angazhoheni dhe të komunikoni me kryetarin e Kamenicës, Qëndron Kastrati me qëllim që ai të tërheq vendimin e tij, që gjoja në emër të reformave, të mbyll një numër shkollash në komunën e tij”, për të vazhduar se SBASHK është angazhuar shumë që ky vit shkollor të fillojë mbarë, por ja insistimi i kryetarit Kastrati për

të mbyllur shkolla ka krijuar situatë të acaruar atje dhe ne duke respektuar zërin e kolegëve tanë në Kamenicë jemi munduar përmes dialogut e takimeve me Kastratin të arrijmë marrëveshje që ai të tërheq vendimin e tij për mbyllje shkollash, bile për këtë vit shkollor dhe se që kjo çështje tepër e ndjeshme të analizohet mirë në nivel qendror pas votës së tetorit kur edhe do të formohen institucionet e reja të Kosovës të dala nga vullneti i popullit përmes votës së lirë.

“Ju përsërisht të bindur se, si gjithmonë, edhe tani do të angazhoheni me tërë mundësitë për të arritur deri të marrëveshja që të mos mbyllet as edhe një shkollë as në Kamenicë e as kudo tjetër”, thuhet në fund të letrës së SBASHK-ut drejtuar Drejtorit Istogu.

# SBASHK



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS

Takim me drejtorin e Departamentit të Pensioneve të Kosovës

## **U bashkëbisedua për fillimin e aplikimit për Ligjin e viteve të 90-ta**



Më 15 gusht ka nisur aplikimi i punëtorëve të arsimit shqip për të gëzuar shtesën në pensionin bazë që ua siguron Ligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip për vitet e 90-ta. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për organizim të

brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe asistenten në SBASHK Vlora Rexhepi Berisha kanë vizituar Departamentin e Pensioneve të Kosovës dhe janë takuar me drejtorin e këtij Departamenti, z. Bahri Xhaferi dhe me zyrtarë të tjerë. Delegacioni i SBASHK-ut në këtë takim ka përsëritur shqetësimin pse është kërkuar fatura për tatimin në pronë, e cila si kujtuan ata, nuk është përmendur në Udhëzimin Administrativ të MASHT.





Drejtori Xhaferi tregoi se kjo është bërë me qëllim që të përcaktohet saktë adresa e banimit të përfuturit të shtesës dhe se ky Departament nuk shikon sa ka paguar aplikuesi e sa i ka mbetur borxh nga obligimi tatimor, por se shikohet adresa e saktë e tij.

Drejtori i Departamentit të Pensioneve ka njoftuar po ashtu se aplikimi ka nisur nëpër komuna dhe se është duke ecur me ritëm normal. Ai ka rikujtuar se me të filluar implementimi i Ligjit, pensionistët e arsimit, që kanë punuar në vitet e 90-ta, shtesën në emër e në respekt të punës në ato vite do ta marrin në mënyrë retroaktive nga muaji kur ligji është botuar në gazetën zyrtare, nëse aplikojnë në kohën e paraparë nga Ministria jonë. Ai pastaj ka dhënë edhe sqarimin në pyetjen e SBASHK-ut se bashkëshorti e bashkëshortja që ende nuk kanë moshën e pensionimit a mund ta gëzojnë që tani shtesën për bashkëshortin a bashkëshorten në emër të punës në vitet e 90-ta.

Drejtori Xhaferi ka shpjeguar se me ligj është e përcaktuar se individ i pensionin, por edhe cilën do shtesë që ka të bëjë me skemat pensionale e gëzon vetëm kur pensionohet, e jo para kësaj moshe dhe kur është duke punuar.



Të dy palët janë shprehur të gatshëm që të vazhdojnë me takimet dhe bashkëpunimin në shërbim të pensionistëve të arsimit.

Kanë rinisur trajnimet e organizuara nga SBASHK

## Nismë e mbarë e trajnimit për mediet dhe rolin e tyre në shoqëri



Në komunën e Prishtinës si dhe të Vushtrisë 90 mësimit filluan trajnimin për mediet dhe rolin e tyre në shoqëri, organizuar nga SBASHK-u me trajnerët, që janë profesorë të Departamentit të Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës.

Për t'i përshëndetur e për t'ju uruar fillim të mbarë të vitit shkollor dhe të këtij trajnimi pjesëmarrësit i ka vizituar kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj bashkë me menaxherin për financa e administratë dhe



koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, zyrtaren për medie dhe trajnime, Rrezarta Bahtijari dhe kryetarin e Kuvendit të SAF e SAM të Prishtinës, Ahmet Pllana. Ata kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit e trajnimit dhe me trajnerët dhe kanë parë nga afër se kushtet e punës janë të mira këtu. Pas kësaj përfaqësuesit e SBASHK-ut u kanë shpërndarë fletore dhe materiale të tjera të trajnimit, dhuratë këto nga Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës.





Ky trajnim ka zgjuar interesim të madh të mësimitdhënësit e Prishtinës dhe komunave tjera dhe prandaj trajnerët Alban Zeneli, Muhamet Jahiri, Remzie Shahini Hoxha dhe Faton Ismajli janë shprehur të kënaqur me dinamikën e punës dhe me përkushtimin e vijuesve të trajnimeve.

Po i njëjti trajnim ka nisur edhe në komunën e Vushtrrisë me trajnerët Gëzim Qerimi dhe Dren Gerguri. Për t'ju uruar fillimin e vitit të ri shkollor dhe angazhim e arritje të larta në këtë trajnim ata i ka vizituar nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala bashkë me kryetarin e SAF e SAM të Vushtrrisë, Alush Maloku.. Ata kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit në këtë trajnim dhe kanë uruar që viti i ri shkollor të jetë me plot arritje në punën edukative e arsimore dhe në angazhimet e shumta sindikale .

SBASHK-u do të vazhdojë me trajnimet edhe në komunat tjera të Kosovës duke kontribuar kështu që



kolegët tanë kudo jenë të marrin dije të reja nga sfera të ndryshme arsimore e sindikale dhe të arrijnë numër të konsiderueshëm të numrit të orëve të trajnimit, orë këto që kërkohen për licencat dhe gradimet në të ardhmen.

Do theksuar se në Pejë është rifilluar me këtë aktivitet duke organizuar në shkollën “Lidhja e Prizrenit” trajnimin për udhëheqje dhe menaxhim të institucioneve arsimore me trajnerin prof. dr. Hysen Sogojeva. Edhe pjesëmarrësit në këtë trajnim i ka vizituar kryetari i SBASHK-ut duke ju uruar punë të mbarë dhe duke treguar se SBASHK-u këto trajnime kudo në Kosovë është duke i organizuar me qëllim që t’u ndihmohet anëtarësisë për marrjen e njohurive nga lëmi të ndryshme, por edhe për të arritur sa më afër numrit të kërkuar të orëve të trajnimit për licencat dhe gradimet.

